



| | | | |
|---|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Pritjenj/Prodato Received/Delivery | 31-05 | 2021 | viti god year |
| Organ /Njesia Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtesa Prileg Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPM/BEK | 2753 | 2021 | 119 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 321/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi – Bajraktari kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin më numër 2462/2019 të datës 15.04.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me date 30.04.2021, kane shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 469/2019, të datës 15.08.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga „Ali Sokoli”, A -40 /1 /15, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 31.05.2021, mori këtë;

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A. Nr.469/2019, e datës 15.08.2019, e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi 2574, i datës 12.07.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

A r s y e t i m

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datë 28.02.2019, ka shpallur konkursin për pozitën „Zyrtar i Lartë Ligjor” në Departamentin Ligjor-Divizioni për Shqyrtimin e Parashtrësive dhe Ankesave, pas marrjes së autorizimit për shpalljen e konkursit nga Ministria e Administratës Publike/ Departamenti për Shërbimin Civil të datës 26.02.2019.

Ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs i cili nga Komisioni Përzgjedhës është përfshirë në listën e shkurtër dhe ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit, por nuk është përzgjedhur si kandidat i suksesshëm për këtë pozitë.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 24.04.2019, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën " Zyrtar i Lartë Ligjor ", në Departamentin Ligjor-Divizioni për Shqyrtimin e Parashtresave dhe Ankesave, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale", me datë 24.05.2019, ka parashtruar ankesë me numër 951 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datë 12.07.2019, ka nxjerr vendim me numër protokollit 2574, me të cilën e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar në ligj.

Ankuesi, i pakënaqur me vendimin me nr. protokollit 2574/2019, datës 12.07.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datën 13.08.2019, për mes Postes së Kosovës, ka parashtruar ankesën e cila ankesë është pranuar me datë 15.08.2019, me numër protokollit 3595/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit për pozitën „Zyrtar i Lartë Ligjor“, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është zhvilluar në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore në fuqi, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 03.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 31.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2224/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 22.08.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 18.07.2019.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me datë 15.04.2021, me numër A.nr. 2462/2019, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e detyruar që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me aneksen e ankuesit

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 19.08.2019, me numër protokollit 3116/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies

Sociale, ndërsa me datën 26.08.2019 me numër protokoll 3882/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 469/2019, e datës 15.08.2019, me numër protokoll 3595/2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 18.03.2019, për themelimin e Komisionit përzgjedhës; Akt Emërimi i datës 24.04.2017; ndryshimi dhe plotësimi i Akt Emërimi i datës 11.01.2019; Akt Emërimi i datës 07.02.2017; Akt Emërimi i datës 06.02.2015; Njoftimi i datës 11.07.2019; Vendimi i datës 12.07.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimi i datës 24.04.2019; Regjistrimi i Aplikacioneve; Përcaktimi i Kriteve për përfshirjen në listën e ngushtë; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues; Konkursit i datës 28.02.2019; Autorizimi i datës 26.02.2019, i Ministrisë së Administratës Publike; Testi me shkrim; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; vërtetimi i datës 19.12.2016; Diplomë e datës 22.11.2014; dëshmi nga trusti prej datës 01.08.2002, deri me datën 06.02.2019; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 03.03.2013; Diplomë e datës 29.06.2011; Kontratë e punës; Përgjigje në ankesë e datës 26.08.2019, me numër protokoll 3882/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se në konkursin e shpallur të datës 28.02.2019 nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për pozitën „Zyrtar i Lartë Ligjor“, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diplome Universitare; Fakulteti Juridik*
- *Tri (3) vite përvojë punë profesionale*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, njoftimin për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm e për pozitën „Zyrtar i lartë Ligjor“, e ka publikuar me datën 24.04.2019, ndërsa ankuesi ankesën me numër protokoll 182, e ka parashtruar me datën 24.05.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, e që është jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesave në rastin e zhvillimit të Procedurës së rekrutimit, respektivisht jashtë afatit të përcaktuar ligjor me dispozitat e nenit 43 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *“Kur një nëpunës civil ose kandidat, në një procedurë të rekrutimit është i pasuksesshëm dhe nuk emërohet në pozitën përkatëse dhe ai/ajo mendon se emërimi i një personi tjetër në atë pozitë nuk është bërë në bazë të meritës ose është bërë si pasojë e parregullsive, ai/ajo mund të ankohet me shkrim në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, i cili e shqyrton dhe vendos për ankesën”* dhe paragrafit 2 i cili përcakton se: *“Ankesat duhet të dorëzohen brenda 30 ditëve nga data në të cilën vendimi për përzgjedhje dhe emërim shpallet nga institucioni përkatës”*. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se në rastin konkret ankuesi ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e ka parashtruar pas kalimit të afatit tridhjetë ditor

(30), përkatësisht në ditën e tridhjetë e një (31) pas publikimit të njoftimit për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm për pozitën „ Zyrtar i lartë Ligjor”, me çka nënkuptohet se është jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesave në rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit respektivisht nga data në të cilën vendimi për përzgjedhje dhe emërim shpallet nga institucioni përkatës”.


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me rastin e nxjerrjes së Vendimi 2574 , të datës 12.07.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka arritur që të trajtoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike, lidhur me procedurën e ndjekur të ankimit nga ana e ankuesit në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. Nr. 321/2021

Rushit KAJTAZI



Procesmbajtës

Malsore Gashi - BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Arkivit të KPMSHCK-së

